PRIMETRAVEL
Smile

Kontrata Nr:

26 _K.K-182_KORPORATE/INSTITUCION

MEMORANDUM BASHKËPUNIMI PËR SHËRBIME ME
- KONTRATË -

SHËRBIME TË OPERATORËVE TË UDHËTIMIT

Ky Momorandum Bashkëpunimi për Shërbime ("Kontrata") është nënshkruar dhe është bërë efektive me datën 7 prill 2026, ndërmjet palëve kontraktuese në vijim:

1. **PRIME TOURS & TRAVEL SH.P.K.,** me seli në adresën rruga Luan Haradinaj, Edit Durham no 21, Prishtinë 10000, Kosovo, me numër të regjistrimit unik të biznesit **811982215**, e përfaqësuar nga z. Fisnik Dragusha, në cilësinë e Drejtorit Menaxhues

(më tutje referuar si PRIME TOURS & TRAVEL SH.P.K.).

s
Dhe

2. **FEDERATA E GJIMNASTIKES E KOSOVES**, me seli në adresën rruga **AGIM RAMADANI, 10 000 Prishtine,** me numër fiskal **601012199 dhe regjistrim 5114560-7**, e përfaqësuar nga **SHKUMBIN MAQASTENA** me numer leternjoftimit **1175775486, President.**

(më tutje referuar si: "Pranuesi i Shërbimeve").

Së bashku referuar si "Palët"

RECITALET

DUKE QENË se PRIME TOURS & TRAVEL SH.P.K.është një ndërmarrje e cila është e regjistruar dhe vepron në përputhje me ligjet e Kosovës dhe e cila aktivitet primar ka, ndër të tjera, ofrimin e shërbimeve të tour operatorëve apo organizatorit të udhëtimeve, shitjen e biletave të udhëtimit dhe organizimin e udhëtimeve grupore dhe individuale me avion dhe forma të tjera të udhëtimit, organizimin e programeve të veçanta të udhëtimit sipas kërkesës, organizimin e trajnimeve dhe seminareve jashtë territorit të Kosovës, organizimin e programeve kulturore dhe rekreacionale, organizimin e pushimeve verore dhe dimërore.

DUKE QENË se PRANUESI I SHËRBIMEVE është a) Korporatë apo b) shoqatë profesionale e cila ka për mision promovimin dhe fuqizimin e sportit në nivel lokal, kombëtar, regjional dhe ndërkombëtar, përmes organizimit, rregullimit dhe mbikqyrjes të aktiviteteve sportive;

Neni 2
Hyrja në fuqi

1. Kontrata do të hyjë në fuqi me nënshkrimet e Palëve dhe do të jenë në kohëzgjatje për një peridhë fillestare prej dy (2) viteve.

2. Në rast se asnjëra prej palëve nuk dërgon një Njoftim me shkrim për shkëputjen e Kontratës të paktën gjashtë (6) muaj para afatit të skadimit të Kontratës, konsiderohet se Kontrata është vazhduar në mënyrë automatike edhe për një afat shtesë prej dy (2) viteve.

Neni 3
Ofrimi i shërbimeve të organizatorit të udhëtimeve

I. PRIME TOURS & TRAVEL SH.P.K. duke analizuar dhe kuptuar nevojat e federates pjese e te cilave eshte Lobimi, Promovimi, Vetedijesimi ne Nivel Lokal dhe Regjional, mbi aktivitetet sportive dhe rendesin e sportit nder vite, vendos qe te gjitha linjat e veta sherbyese ti veje ne dispozicion duke perfshire:

   a. Nje puntor i PRIME TOURS & TRAVEL SH.P.K. do te jete i angazhuar enkas per sherbimet dhe kerkesat ndaj Pranuesit te Sherbimeve.

II. PRIME TOURS & TRAVEL SH.P.K. SH.P.K .obligohet që t'i ofrojë PRANUESI I SHËRBIMEVE-së të gjitha shërbimet e tour operatorëve apo organizatorit të udhëtimeve, shitjen e biletave të udhëtimit, aranzhimit të akomodimit dhe organizimin e udhëtimeve grupore dhe individuale, duke përfshirë por mos u kufizuar në shërbimet në vijim:
   a. Bileta udhëtimi në tërë botën për nevojat e PRANUESI I SHËRBIMEVE-së dhe Stafit të saj;
   b. Organizimin e udhëtimeve Charter, sipas nevojes;
   c. Akomodim në Hotele dhe resorte për aktivitete zyrtare dhe private të PRANUESI I SHËRBIMEVE-së dhe të Stafit;
   d. Mundesi organizimi në all-in-one për Trajnime, Seminare, Refreshment, Team-Building, organizimit të ndeshjeve miqësore, organizimit të trajnimeve për PRANUESI I SHËRBIMEVE dhe ekipet jashtë vendit dhe të ngjashme;
   e. Pushime Verore dhe Dimërore me sistem online rezervimi, duke përfshirë vende si Kosova, Bullgaria, Turqi, *Greqi, Bullgari, Spanje, Egjipt;etj.*
   f. Programe Kulturore me sistem online rezervimi, në vende si Dubrovnik, Dubai, Paris, Venecia, dhe të ngjashme;
   g. Cruise apo Krociera në destinacione për Kosoven, me sistem online rezervimi;
   h. Sport dhe Koncerte me sisteme online të rezervimit;
   i. MICE – Organizim te Eventeve, Konferencave etj.

- Të siguroj transportin, kjo sipas ofertës së prezantuar nga PRIME TOURS & TRAVEL SH.P.K.
- Të siguroj përcjellësin në kujdesje të pasagjerëve gjatë tërë kohës sipas kërkesës dhe ofertës së bërë;
- Të ofrojë dhe asistoj mundësinë për sigurimin shëndetësor, përpos rasteve të refuzimit të klientit;
- Të informojë klientin saktë mbi kushtet, limitet kohore dhe gjobat e mundshme në rast të anulimit, refundimit, ndryshimit të itenerarit apo mos-paraqitjes në aeroport në kohën e udhëtimit;
- Të procesojë kërkesat e klientit brenda një (1) dite pune pas pranimit të kërkesës, duke ja ofruar klientit së paku 3 produkte të ndryshme sipas ofertave ekzsituese për përzgjedhje;
- T'i ofroj klientit zbritjet e merituara bazuar në plotesimin e kushteve për të përfituar një benefit të tillë nga shërbimet e marra;
- Të informoj klientin me rregullat e përgjitheshme të udhëtimit, ligjet kufitare dhe nevojat tjera të rrugës;
- Në rast se nga agjencia merret përsipër organizimi i udhëtimit në tërësi, asistimi dhe procesimi i Kërkesave për viza.

3. PRIME TOURS & TRAVEL SH.P.K.merr përsipër që të angazhoj staf të dedikuar të zyrës për nevojat dhe kërkesat e PRANUESI I SHËRBIMEVE-së, kjo me qëllim të procesimit të shpejt të kërksave të PRANUESI I SHËRBIMEVE-së.

Neni 5
Ekskluziviteti dhe mos-konkurueshmëria

1. PRANUESI I SHËRBIMEVE zotohet dhe garanton se për gjatë tërë kohëzgjatjes së Kontratës do të marrë të gjitha shërbimet e parashikuara me këtë Kontratë, më specifikisht me Nenin 3, vetëm tek PRIME TOURS & TRAVEL SH.P.K..

2. Shkelja e detyrimit të ekskluzivitetit dhe mos-konkurueshmërisë nga ana e PRANUESI I SHËRBIMEVE-së konsiderohet shkelje materiale e kushteve të Kontratës.

3. Për qëllime të interpretimit të Kontratës, ekskluziviteti interpretohet në mënyrë të gjerë, për të mbuluar të gjitha shërbimet të cilat ofrohen apo mund të ofrohen nga ana e PRIME TOURS & TRAVEL SH.P.K.në kuadër të fushë-veprimtarisë së saj biznesore.

4. PRANUESI I SHËRBIMEVE përfaqëson dhe garanton se nuk do të hyjë në marrëveshje apo kontrata me palë të treta me qëllim të promovimit të punës dhe shërbimeve të tyre, pa pëlqimin paraprak të PRIME TOURS & TRAVEL SH.P.K., në rast se ato palë të treta janë në konkurencë direkte me PRIME TOURS & TRAVEL SH.P.K..

Neni 6
Çmimi dhe kushtet e pagesës

1. PRANUESI I SHËRBIMEVE-ja do bëjë pagesën për të gjitha shërbimet e pranuara në përputhje me këtë Kontratë, në përputhje me listën e çmimeve dhe ofertave specifike me shkrim të bëra nga PRIME TOURS & TRAVEL SH.P.K., kundrejt lëshimit të faturës nga ana e PRIME TOURS & TRAVEL SH.P.K.

2. Fatura lëshohet në ditën e konfirmimit (përmes forms elektronike – E-Mail, tek: kosovagymnasticsfederation@gmail.com) të shërbimeve të kërkuara, dhe është e pagueshme brenda një afati prej shtatë (7) ditësh nga data e lëshimit. Fatura është e vlefshme dhe e pagueshme pas kalimit të këtij afati në mënyrë automatike, dhe nuk kërkohet nënshkrimi i palës tjetër për vlefshmërinë e Kontratës.

Neni 9
Detyrimet e Klientit
1. Klienti është përgjegjës për respektimin e kushteve të udhëtimit dhe kërkesave ligjore, sikurse informohet nga PRIME TOURS & TRAVEL SH.P.K.dhe/ose avio-kompania dhe Hoteli.

2. Te respektoj afatet e pagesave sipas detajeve te fatures, dhe afataveve te lejuara nga ofruesi i sherbimeve.

Neni 10
Të Drejtat e Klientit

1. PRANUESI I SHËRBIMEVE dhe udhëtarërët nga PRANUESI I SHËRBIMEVE gëzojnë të gjitha të drejtat ndërkombëtare të udhëtarit me rastin e udhëtimit dhe shfrytëzimit të shërbimeve të ofruarar nga PRIME TOURS & TRAVEL SH.P.K.sipas kësaj Kontrate.

2. Përveç të drejtave nga paragrafi 1, PRIME TOURS & TRAVEL SH.P.K.obligohet që të ndërmerr të gjitha veprimet e kërkesës për kompensim dhe përfaqësimit të udhëtarëve nga PRANUESI I SHËRBIMEVE në rast të dështimit të ndonjë fluturimi apo vonesave të paarsyeshme të shkaktuara nga palët e treta dhe aviokompanitë pa fajin e PRIME TOURS & TRAVEL SH.P.K.dhe të PRANUESI I SHËRBIMEVE.

3. PRANUESI I SHËRBIMEVE ka të drejtë të kontaktoj personelin e veçantë të dedikur për shërbime ndaj PRANUESI I SHËRBIMEVE në çdo kohë gjatë orarit të rregullt të punës në lidhje me ankesat dhe vërejtjet e mundshme që mund të paraqiten në lidhje me udhëtimet e organizuara nga ana e PRIME TOURS & TRAVEL SH.P.K..

Neni 11
Transferimi i Kontratës
1. Palët nuk mund të caktojnë të drejtat dhe detyrimet sipas kësaj kontrate dhe do të mbeten përgjegjës për të gjitha dëmet si rezultat i moszbatimit ose mosrespektimit të kushteve të kësaj kontrate.

Neni 12
Njoftimet dhe komunikimi
Njoftimet sipas kësaj Kontrate duhet të bëhen me shkrim dhe të dërgohen te një palë duke përdorur të dhënat në Kontratë dhe çdo Shtojcë të tij, ose ndonjë detajim zëvendësimi të njoftuar me shkrim. Njoftimet mund të dërgohen me email në Palën tjetër nëse një adresë e-mail është dhënë në Kontratë, me kusht që të jepet një "dëshmi e leximit" ose të jepen dëshmi të tjera të pranimit - për shembull, përgjigja e marrësit. Nëse kjo nuk jepet, atëherë njoftimi duhet të dërgohet me mjete të tjera të tilla si me postë ose me dorë.

	Për PRIME TOURS & TRAVEL SH.P.K.	PRANUESI I SHËRBIMEVE
Emri	Fisnik Dragusha	**Shkumbin Maqastena**
pozitë	CEO, Drejtor Menaxhues PRIME TOURS & TRAVEL SH.P.K.	**President**
Email / Phone	+383 43 80 70 60	**+386 44 686 077 / +383 44 145 009**

Neni 18
Klauzola bashkimi

1. Kontrata përmban kuptimin e plotë të Palëve, përcakton shpërndarjen e plotë të rrezikut midis tyre dhe përbën një deklaratë të plotë dhe ekskluzive të termave dhe kushteve të marrëveshjes së tyre lidhur me çështjet e përmendura në këtë Kontratë. Të gjitha negociatat paraprake, marrëdhëniet, kuptimet dhe marrëveshjet me gojë ose me shkrim lidhur me këtë Kontratë, tani zëvendësohen nga kjo Marrëveshje.

Neni 19
Ligji në fuqi dhe zgjidhja e mosmarrëveshjeve
1. Kontrata i nënshtrohet ligjeve të Republikës së Kosovës.

2. Çdo mosmarrëveshje, kundërthënie ose kërkesë që rrjedh nga ose në lidhje me këtë kontratë, duke përfshirë vlefshmërinë, pavlefshmërinë, shkeljen ose përfundimin e saj, zgjidhen nga Gjykata Themelore në Prishtinë, Kosovë.

Palët në kontratë kanë nënshkruar dhe datuar atë më poshtë:

Për dhe në emër të PRIME TOURS & TRAVEL SH.P.K.

Emri: Fisnik Dragusha
Titulli: Drejtor Menaxhues

Data: 01.04.2026

Vula:

FEDERATA E GJIMNASTIKES E KOSOVES
PRANUESI I SHËRBIMEVE, Për dhe në emër të:

Emri: SHKUMBIN MAQASTENA
Titulli: President

Data: 01.04.2026

Vula:

FEDERATA E GJIMNASTIKËS E KOSOVËS
FGJK - KGF
KOSOVA GYMNASTIC FEDERATION